

# **NARCIZMI, SI SËMUNDJE KOLEKTIVE E PERËNDIMIT**

Nga Dritan Goxhaj

23 shkurt 2024

Midis datave 16 dhe 18 shkurt 2024 u mbajt në Mynih të Gjermanisë konferenca vjetore mbi sigurinë, ose siç njihet tashmë, Konferenca e Sigurisë e Mynihut.

Kjo konferencë këtë vit përkoi me dy vjetorin e luftës në Ukrainë, edhe pse lufta pat filluar 4 ditë më herët, më datë 22 shkurt 2022.

Por kjo konferencë ka simbolikën e saj, pasi aty e ka fillesën gjithë kjo luftë që po zhvillohet në Ukrainë midis Perëndimit –NATO-s, dhe Ruisë. Ishte pikërisht në atë konferencën e vitit 2007 që presidenti i Ruisë, Putin, mbajti një fjalë në të cilën, prej fillimit të saj e deri në fund, u mundua t'i tërhiqte vëmendjen gjithë Perëndimit që të mos shtyhej më në drejtim të Ruisë, dhe të qëndronte larg kufijve të saj, pasi, çdo përpjekje për t'u afruar ushtarakisht në kufijt e saj, do të konsiderohej nga Rusia si një veprim që do t'i jepte fund bashkpunimit të deri më atëherëshëm të tyre, dhe do të konsiderohej si një përpjekje drejt ekzistencialitetit të vetë shtetit rus. Fjala e Putinit atëherë, por jo vetëm atëherë, ajo u nënvlerësua totalisht. Gjithë Perëndimi, i marë së bashku, pra, Perëndimi kolektiv deri më datë 22

shkurt të vitit 2022 e konsidronte Rusinë sipas shprehjes së senatorit amerikan Lindsi Graham:

***“Një pompë benzine i maskuar si shtet”.***

Po i njëjti nënvlerësim erdhi edhe më pas për gjithë rritjen e kapaciteteve ushtarake ruse nga viti në vit, si dhe u vazhdua nënvlerësimi i kapaciteteve ushtarake, doktrinale dhe operacionale të ushtrisë ruse.

Ai ishte një nënvlerësim, i cili vinte dhe vjen edhe si pasojë e njohjes së gabuar të historisë së Luftës së Dytë Botërore. Por, Perëndimi kolektiv, përveç nënvlerësimit total ndaj Rusisë, ai bëri edhe gabimin tjetër fatal, i filluar që nga viti 1991, vit në të cilin u shpërbë Traktati i Varshavës, duke mbivlerësuar veten dhe fuqitë dhe kapacitetet e veta ushtarake. Dhe, sikundër dihet, në fushën e psikologjisë dhe të mjekësisë kur dikush nënvleftëson totalisht dikë ose diçka, dhe krijon idenë e mbivlerësimit për veten, vuan nga ajo sëmundje që këto dy shkenca e konsiderojnë si sëmundjen e narcizmit.

Të rënë në këtë gjendje narcizmi edhe kësaj rradhe në Konferencën e Mynihut të këtij viti, u fol vetëm për një paketë të re sanksionesh ndaj Rusisë, si dhe për islamofobin Navalni (si politikë të partisë së tij, ku propagandonte zhdukjen e gjithë myslimanëve në Rusi, dhe e konsideronte shtetin rus vetëm shtet të krishterëve ortodoksë).

Duket qartësisht që narcizmi nuk e ka lejuar as kësaj rradhe Perëndimin kolektiv që të shohin realitetin; realitet i shpjeguar nga një raport i FMN (Fondi Monetar Ndërkombëtar) në fund të vitit që shkoi, ku theksonte se **“Sanksionet nuk e kanë dëmtuar aspak Rusinë, dhe ekonomia e saj ka pësuar rritje më shumë se ekonomia e vendeve të G7”**.

Por, të mbytur nga narcizmi, Perëndimi ka menduar se Rusia është si Shqipëria, një vend i vogël ku pushteti merret dhe mbahet me ndihmën e bandave dhe banditizmit.

Rusia është një vend i madh, dhe vendet e mëdha, nëse funksionojnë në kuadër të banditizmit, ato humbasin centralizmin dhe shpërbëhen.

Ndërsa vende si Shqipëria mund të drejtohen dhe mbahen me banditë. Sepse aktualisht e gjitha çka bën qeveria e Shqipërisë është thjesht dhe vetëm banditizëm ndaj popullit të vet, dhe për këdo që do të ndihet keq me çka shprehem, mjafton të shikojë definicionin e banditizmit në Ëikipedia: “Termi banditizëm aplikohet për ata që vetëm ose në grupe kryejnë akte të jashtëligjshme në vepra të cilat janë: grabitja, pengmarrja dhe gjobëvënia”.

Me cilat nga këto nuk merret qeveria shqiptare me udhëheqjen e saj?

Grabit paratë publike me projekte si inceneratorët si dhe aeroportet e rrugët. Ka marrë peng një popull të tërë nëpërmjet patronazhizmit, dhe gjobëvënie ndaj

çdo lloj biznesi, deri te taksimi i çdo lloj profesioni të lirë.

Është pra, narcizmi që e çoi Perëndimin kolektiv drejt shkatërrimit të plotë të ushtrisë më të madhe të Europës, atë të Ukrainës.

Dihej që në fillim të vitit 2022, se Ukraina zotëronte ushtrinë më të madhe dhe më të përgatitur të gjithë Europës.

Dhe në kuadër të narcizmit, duke nënvlerësuar totalisht kapacitetet dhe aftësitë ushtarake të ushtrisë Ruse, Perëndimi nuk e la Ukrainën që të dakordohej për një marrëveshje paqeje në fillimin e këtij konflikti, që sërish Perëndimi, kuptohet për shkak të narcizmit të tij, vijon që atë konflikt ta konsiderojë luftë, ndërsa Rusia e konsideron thjesht si një Operacion Ushtarak; dhe Perëndimi ka atë përcaktim jo vetëm si pasojë e nënvlerësimit të Rusisë, por edhe si rrjedhojë e mos-njohjes së doktrinës ushtarake Ruse.

Në doktrinën e saj Rusia i ndan veprimet luftarake në dy grupe. Në Teatër Luftë, dhe në Teatër Operacional të Luftimit. Po në këtë kuadër, çdo lloj angazhimi i forcave Ruse jashtë territorit të saj konsiderohet vetëm si Teatër Operacional Luftimi; për këtë arsye ajo e quan atë që po bën në Ukrainë thjesht Operacion Special. Dhe këto përcaktime në doktrinën ushtarake Ruse janë definuar të tillë prej pasi mbaroi Lufta e Dytë Botërore. Rusët e trajtojnë

Teatër Luftë vetëm atëherë kur gjithë shteti angazhohet totalisht në luftë dhe bëhet mobilizimi i përgjithëshëm i gjithë popullsisë dhe kur ekonomia vihet totalisht në shërbim të luftës.

Narcizmi nuk e lejon Perëndimin kolektiv që të shohi realitetin në terren, ku tashmë prej dy vite të plota në këto përplasje ushtarake, ushtria ukrainase është shkatërruar plotësisht, ku numëri i të vrarëve të saj është 377.324, duke e ka kaluar numërin aktual të forcave ushtarake aktive, i cili është 366,400; 11.000 më pak se ai i të vrarëve.

Gjithashtu, në ushtrinë ukrainase është shkatërruar çdo lloj sistem armatimi dhe i llojeve të armatimit që Perëndimi i ka dhënë Ukrainës, gjë që është treguar se ato armatime dhe sisteme të ndryshme perëndimore nuk kanë qënë të përshtatshme për një luftë të tillë, por vetëm për operacione të shkurtra e të vogla për vende të izoluara, e jo me kapacitete ushtarake si të Rusisë.

Edhe pse para disa ditësh revista prestigjoze “Forbes” shkruante: *“Ukrainës i duhen 200,000 predha artilerie në ditë që të mund të ndalojë avancimin e forcave ruse në Ukrainë”*, sërish Perëndimi kolektiv, i qorruar nga narcizmi, nuk e sheh se nuk është në gjendje t’i japi Ukrainës një sasi të tillë municionesh, pasi gjith sasia e predhave që ka prodhuar gjithë Perëndimi së bashku gjatë vitit 2023 ka qënë 400,000 predha, ndërsa për vitin në

vijim 2024 kanë planifikuar vetëm 600,000 predha të tilla. Që, sipas revistës “Forbes”, Perëndimi do të plotësojë nevojat vetëm për 3 muaj të ushtrisë Ukrainase, por edhe ato për vitin tjetër, sepse kjo sasi do të prodhohet deri në fund të vitit 2024.

Ndërsa në fillim të këtij muaji shkurt, dy gjeneralë perëndimorë, Gjeneral Majori në pension Mik Rajan (Mick Rayan) i ushtrisë Australiane, dhe Gjeneral Leitnanti Klinton Hinot (Clinton Hinote) i Forcave Ajrore Amerikane, kanë bërë një raport për Pentagonin, në të cilin theksojnë: *“Menjëherë pas Luftës së Ftohtë ndodhën disa gara të njëanshme në fushën e betejës, ku ushtritë aleate dominuan shpejt kundërshtarët të mbërthyer në paradigma të vjetra. Fatkeqesisht tashmë ky avantazh është gërryer me shpejtësi të madhe”*.

Ndërsa diku më poshtë në raportin e tyre, ata pranojnë se, *“Sistemet pëëendimore janë bërë aq të shtrenjta, sa operatorët e tyre kanë frikë t’i përdorin – duke shkatërruar kështu gjithë idenë e luftës”*.

Duke qënë se narcizmi nuk të lejon ta shohësh realitetin dhe as ta pranosh atë, Perëndimi kolektiv sërish po e nxit Ukrainën për të vazhduar konfliktin, edhe pse tashmë është reale pamundësia e Ukrainës për të ndalur avancimin e forcave Ruse, të cilat, si për kastile, një ditë para Konferencës së Mynihut arritën të marrin totalisht nën kontrollin e

tyre një nga qyetet më të fortifikuara të forcave ukrainase, atë të Advikës.

Tashmë ukrainasve ju kanë mbetur vetëm dy rajone të fortifikuara, ai i Shasov Jar, dhe linja e fortifikuar në Kramatorsk. Aktualisht Shasov Jar është duke u rrethuar nga forcat ruse që po përparojnë me ritëm të ngadaltë.

Në momentin që edhe këto dy rajone të fortifikuara do të bien në duart e rusëve, atëherë Ukraina nuk do të ketë më asnjë lloj mundësie për të ndalur avancimin e rusëve deri në brigjet e lumit Dniepër. Edhe pse Ukraina po mundohet që të ribëjë sërish një mobilizim, me pretendimin se do të mund të mobilizojë rreth 500 mijë forca, ajo thjesht e nxitur nga narcizmi i Perëndimit dhe nga pangopësia e lavdisë dhe e pushtetit të presidentit të saj, do të çojë drejt vdekjes bijtë e bijat e Ukrainës, pasi ato janë froca që jo vetëm do të jenë të pa-përgatitura, por Ukraina tashmë nuk ka asnjë kapacitet njerëzor profesionist komundes.

Kjo vërtetohet nga fakti që gazetatat amerikane po arrijnë të marrin nëpër intervista disa komandatë batalionesh ukrainase, që po ikin nga Advika, dhe grada e tyre është herë kapiten e herë major.

Ndërkohë që normalisht duhej të ishin Kolonelë ose nën/kolonelë. Kur një batalion ka për komandant një kapiten, më së shumti major, kjo tregon qartësisht mungesën e personelit të kualifikuar drejtues.

Dhe kjo, në një konflikt të tillë, veçanërisht si ky i tanishmi, do të thotë vetëvrasje për ato forca të freskëta që shkojnë në luftim.

Pas gjithë këtyre dështimeve të njëpasnjëshme në këto dy vjet, Perëndimi kolektiv do të duhej ta nxiste Ukrainën që të ulej në tavolinën e bisedimeve dhe të të mund të shpëtonte çka të mund të shpëtonte në këtë pikë ku është aktualisht, pasi, sa më vonë të bëhet kjo, aq më shumë do të humbasi Ukraina.

Por ama, ky narcizëm nuk po e lejon Perëndimin të shohi se, sa më e madhe të jetë humbja e Ukrainës, aq më e madhe do të jetë edhe humbja e Europës dhe e NATO-s.

Në këtë rast Europa do të thyhet përfundimisht në idenë e një fuqie ushtarake edhe për një periudhë tjetër të paktën 30 vjeçare do të duhet të jetë nën patronazhin dhe mbrojtjen direkte të SHBA-së.

Ndërsa NATO-ja thjesht do të dali si një alencë e dobët dhe jo më e frikshme për pjesën tjetër të botës.

I vetmi që, me sa po duket deri më tashti nga luftënxitësit perëndimore që e ka kuptuar se vazhdimi i luftës nga Ukraina është i kotë, është vetëm senatori amerikan Lindsy Graham, i cili deri dje bënte thirrje për angazhim ushtarak të Amerikës direkt me Rusinë, ndërsa tashti, në dy raste të fundit ka votuar kundër dhënies së ndihmës ushtarake amerikane prej 61 milion dollarësh Ukrainës.

Si duket, zoti senator e ka kuptuar më në fund se Rusia nuk është “Një pompë benzine e maskuar si shtet”, por “Një Shtet i maskuar si pompë benzine”. Uroj që edhe pjesa tjetër e Perëndimit ta kuptojë sa më shpejt e të mos luajnë me fatin e Ukrainës dhe të ukrainasve thjesht për interesat e tyre të ngushta politike; pasi është vërtet për të ardhur keq kur sheh se në ç’drejtë ka rënë Ukraina, aq sa edhe “Udhëheqësi ynë global”, z.Rama, po e përdor Ukrainën për kapital të tijin politik, për t’i treguar patronazhistëve dhe gjithë qorrave që i venë nga pas si të shurdhër, se ai është lider global, duke e ftuar presidentin e Ukrainës në datë 28 shkurt, në Konferencën për Ballkanin, që do të mbahet në Tiranë.